



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1265

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Kimete Gashi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.SH.T. VIKTORY COM, kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 09/02/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e N.SH.T. VIKTORY COM., me nr. 2025/1265, e datës 24/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X”, me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KOMUNA E GJAKOVËS për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X”, me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.04.2025 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X”, me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 4,357,000.00€.

Me 05.12.2025 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku ku anuluar aktivitetin e prokurimit.

Me 09.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 16.12.2025 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim

Me 24.12.2025, OEN.SH.T. VIKTORY COM., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1265, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.SH.T. VIKTORY COM., janë parashtruar si në vijim:

Ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) NSHT “VIKTORY COM” Pjetër Qerimi B.I., Company Eskavatori Sh.p.k. dhe Marisa Sh.p.k., në cilësi të palës ankuese, paraqesim këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim dhe është konfirmuar anulimi i aktivitetit të prokurimit:

“Ndërtimi i Rrugës X”

Nr. i Prokurimit: 632-23-397-5-1-1

Kjo ankesë parashtrohet për shkak të shkeljeve të rënda materiale dhe procedurale të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe për shkak të moszbatimit të vendimeve të formës së prerë të OSHP-së.

Mosrespektimi i vendimeve të formës së prerë të OSHP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit në Republikën e Kosovës është organ i pavarur administrativ, i cili vepron në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Ligjit për Administratë. Vendimet e këtij organi janë të formës së prerë dhe obligative për të gjitha Autoritetet Kontraktuese në Republikën e Kosovës.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, pavarësisht këtij fakti juridik, ka dështuar të zbatojë vendimet e OSHP-së, përfshirë edhe vendimin e fundit nr. 2025/0161, duke ndërmarrë veprime të njëanshme dhe në kundërshtim të plotë me urdhrat e organit kompetent.

Sipas parimeve të së drejtës administrative dhe praktikës gjyqësore në Kosovë, Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të interpretojë, relativizojë apo anashkalojë vendimet e OSHP-së. Në rast të pakënaqësisë me një vendim të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues ka vetëm të drejtën ta atakojë vendimin në gjykatë, pa e pezulluar zbatimin e tij.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, të cilat konsistojnë në nxjerrjen e vendimeve të reja në kundërshtim me vendimet e OSHP-së, përbëjnë shkelje të rëndë procedurale dhe materiale të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe funksionimin e rendit kushtetues.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, ka publikuar vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me datë 05.12.2025, në të cilin deklaron se anulimi bëhet për shkak të mungesës së fondeve. Në këtë vendim konstatohet se Drejtoria e Infrastrukturës është bazuar në ndryshimin e projektit sipas Ministrisë së Infrastrukturës, ndërsa po ashtu pretendohet se Zyra Kryesore Administrative (ZKA) ka kërkuar anulimin e aktivitetit për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Ministria e Infrastrukturës, përmes një komunikimi zyrtar me email në vitin 2023, pas vendimit të parë të Organit Shqyrtues të Prokurimit për këtë aktivitet, ka deklaruar qartë se nuk ka kërkuar anulimin e këtij projekti. Pavarësisht këtij fakti të dokumentuar, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar përpjekjet për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke u mbështetur në pretendime të pabazuara dhe pa asnjë dokument zyrtar mbështetës.

Edhe pse nuk ekziston asnjë shkresë, vendim apo dokument formal nga Ministria e Infrastrukturës që do të justifikonte anulimin e këtij aktiviteti, Autoriteti Kontraktues ka tentuar ta paraqesë anulimin si të lidhur me qëndrimin e kësaj ministrie, duke u thirrur vetëm në deklaratime verbale dhe supozime.

Ndërkohë, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka paraqitur një arsyetim tjetër, duke pretenduar se për shkak të mungesës së autorizimeve dhe për shkak të ndryshimeve në Ligjin për Prokurimin Publik, nuk mund të lidhet kontrata. Këto qëndrime janë të ndryshme dhe kontradiktore mes vete dhe tregojnë një ndryshim të vazhdueshëm të arsyeve, varësisht nga faza e procedurës.

Kjo mospërputhje e arsyeve brenda të njëjtit proces administrativ dëshmon mungesë të bazës faktike dhe ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Vendime të tilla, të mbështetura në arsye që ndryshojnë nga një dokument në tjetrin, bien ndesh me parimet e sigurisë juridike, transparencës dhe qëndrueshmërisë së vendimmarrjes administrative.

Veprime të tilla janë në kundërshtim me parimet themelore të administrimit publik, pasi asnjë institucion publik nuk mund të veprojë mbi bazën e fjalëve gojore apo arsyeve të paqëndrueshme, pa pasur dokumentacion zyrtar dhe bazë ligjore të qartë që e mbështet një vendim administrativ.

Situata e krijuar në Komunën e Gjakovës është për të ardhur keq, pasi veprimet e ndërmarra nga disa individë, pa kredibilitet profesional dhe institucional, kanë çuar në keqpërdorim të pozitive shtetërore, duke dëmtuar interesin publik, funksionimin e institucionit komunal dhe interesat e qytetarëve.

FAKTET RELEVANTE

Aktiviteti i prokurimit është shpallur dhe zhvilluar në vitin 2023, nën dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi në atë kohë.

Gjatë këtij aktiviteti, OSHP ka nxjerrë pesë (5) vendime, përfshirë vendimin e fundit nr. 2025/0161, me të cilin:

ankesa jonë është aprovuar;

janë konstatuar shkelje të rënda nga Autoriteti Kontraktues;

është urdhëruar rivlerësimi i ofertave;

është iniciuar procedurë për revokim ndaj menaxherit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, në vend që të zbatojë vendimin e OSHP-së, ka nxjerrë vendim të ri për anulimin e aktivitetit, duke u mbështetur në arsyetime që:

bien ndesh me vendimet e OSHP-së;

bazohen në dispozita ligjore dhe rregullative të ndryshuara në vitin 2024.

SHKELJET LIGJORE

Shkelja e parimit të mosprapaveprimit të ligjit

Autoriteti Kontraktues e ka bazuar anulimin e aktivitetit të prokurimit në dispozita ligjore dhe rregullative të ndryshuara, të cilat nuk kanë qenë në fuqi në momentin e shpalljes dhe zhvillimit të tenderit në vitin 2023.

Sipas parimeve themelore të së drejtës:

Ligji nuk ka veprim prapaveprues, përveç nëse kjo parashikohet shprehimisht me ligj;

Procedurat e prokurimit duhet të vlerësohen sipas ligjit në fuqi në kohën e shpalljes së aktivitetit;

Ndryshimi i rregullave gjatë ose pas përfundimit të procedurës cenon sigurinë juridike dhe barazinë në trajtim të operatorëve ekonomikë.

Aplikimi i dispozitave të reja mbi një procedurë të nisur në vitin 2023 është i kundërligjshëm dhe i papranueshëm.

Anulim artificial dhe i paarsyetuar i procedurës

Pretendimi për mungesë fondesh është:

në kundërshtim me faktin se fondet kanë qenë të planifikuara ndër vite;

në kundërshtim me vendimet e OSHP-së;

i përdorur si mjet për të shmangur zbatimin e vendimeve obligative.

Bazuar në Nenin 62 të LPP-së, një aktivitet i prokurimit mund të përfundojë vetëm për arsye specifike, të cilat në rastin konkret nuk janë të aplikueshme, duke e bërë vendimin tuaj të

jashtëligjshëm dhe abuziv.

Kjo procedurë ka kaluar në rivlerësim katër herë me vendime të OSHP-së, e cila ka konstatuar se ne jemi Operator Ekonomik i përgjegjshëm, ndërsa OE të tjerë janë të papërgjegjshëm.

AK ka refuzuar zbatimin e këtyre vendimeve dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ta anuluar tenderin, duke dëmtuar në mënyrë të qëllimshme konkurrencën dhe duke krijuar dyshime mbi paanshmërinë e saj.

Vendimi për anulimin e tenderit është marrë në kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së, i cili përcakton qartë situatat kur një aktivitet i prokurimit mund të përfundojë:

Neni 62, pika 1.1: Ky aktivitet nuk ka ndonjë shkelje ligjore që kërkon anulimin e tij; përkundrazi, OSHP ka konstatuar se ne jemi të përgjegjshëm dhe ka urdhëruar rivlerësimin.

Neni 62, pika 2.1: Ky tender nuk e ka tejkaluar buxhetin e AK-së, pasi fondet për këtë projekt kanë qenë të planifikuara që në fillim të procedurës.

Neni 62, pika 2.2: Nuk ka asnjë ngjarje objektive të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të AK-së që të justifikojë anulimin, sidomos pasi tenderi është hapur dhe është në fazën e rivlerësimit.

Në këtë rast, AK ka marrë një vendim të kundërligjshëm duke e përdorur si arsyetim mungesën e mjeteve financiare, një arsye e paqëndrueshme dhe e paligjshme, pasi buxheti për këtë projekt ishte i ndarë që në fillim të procesit të prokurimit.

Vendimi i AK-së, Komuna e Gjakovës, është një përpjekje e qartë për të anashkaluar një proces të drejtë dhe transparent, duke dëmtuar konkurrencën dhe duke shkelur të drejtat tona si OE.

Më poshtë gjeni dëshmi ku Komuna e Gjakovës ka ndarë mjetet buxhetore për vitin 2023, 2024 dhe 2024–2026. Më poshtë shihet shumë qartë se Komuna e Gjakovës për këtë projekt, Ndërtimi i Rugës X, i ka të ndara mjetet për vitin 2024 deri në vitin 2026.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Grupi i Operatorëve Ekonomikë N.SH.T. VIKTORY COM, Companya Eskavatori SH.P.K. dhe Marisa SH.P.K., me datë 09.12.2025, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X”, Nr. i prokurimit: 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm: 632-23-003-511.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, me datë 16.12.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit nuk qëndrojnë, sepse shkelje do të ishte po të vazhdonte me procedurat e prokurimit për këtë aktivitet pas njoftimit nga Njësia e Kërkesës (Drejtoria për Infrastrukturë), ZKA dhe ZKF se ky projekt nuk është përfshirë në buxhetin e vitit aktual dhe të dy viteve tjera pasuese.

Sa u përket vendimeve të OSHP-së, pretendimi juaj për mosrespektimin e vendimeve në fjalë nga ana e Autoritetit Kontraktues nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues, çdo herë duke respektuar këto vendime, ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe e ka njoftuar OSHP-në.

Autoriteti Kontraktues është detyruar që të bëjë anulimin e këtij aktiviteti, sepse në të kundërtën do të vepronte në kundërshtim me:

nenin 8, paragrafi 8.5, të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, sipas të cilit:

“Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që, para publikimit të Formularit B58 ‘Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues’, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar.”

nenin 8, paragrafi 8.1, të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, sipas të cilit:

“Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve Kontraktuese bëhet në pajtueshmëri me Nenin 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF do të sigurojë që:

a) fondet janë alokuar; ose

b) fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë.

Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike. ‘Alokimi’ do të thotë këtu ‘shuma është autorizuar’, në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuara është që të përmirësohet efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde të alokuara thjesht mund të jetë humbje e resurseve.”

nenin 22, paragrafi 22.1, të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sipas të cilit:

“Për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, ZKA duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Gjatë caktimit të Zyrtarit Autorizues, ZKA duhet të përmbushë të gjitha kushtet e parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe në Rregullat Financiare të shpallura nga Thesari. Zyrtari Autorizues nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të iniciojë aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit Autorizues Deklaratën përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve, të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF i autoritetit kontraktues, sipas paragrafit 5 të nenit 9 të këtij ligji.”

Bazuar në nenet e lartpërmendura, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 43, paragrafi 43.5, pika i, sipas të cilit procedura e prokurimit pas hapjes duhet të anulohet nëse:

“një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 29.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1265, ndërsa me datë 12.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1265, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit

shqyrtues që ankesa e OE ankues të trajtohet si pjesërisht bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEN.SH.T. VIKTORY COM., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1265 ka vlerësuar si në vijim:

Pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues, dokumentacionit të lëndës, arsyetimit të Autoritetit Kontraktues (AK), si dhe vendimeve të mëparshme të Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr. 2024/0100, 2024/0534, 2024/1022 dhe 2025/0161, eksperti shqyrtues konstaton si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit është iniciuar në vitin 2024 dhe, pavarësisht zhvillimit të disa fazave procedurale dhe trajtimit të katër ankesave paraprake, deri në vitin 2026 nuk ka marrë epilog përfundimtar. Si pasojë, kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore rrethanat faktike, financiare dhe institucionale mbi të cilat është bazuar ky aktivitet i prokurimit.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i lëndës rezulton se Autoriteti Kontraktues, gjatë gjithë kësaj periudhe, nuk i ka zbatuar në mënyrë efektive dhe të plotë vendimet e Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr. 2024/0100, 2024/0534, 2024/1022 dhe 2025/0161, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në zvarritjen e procedurës dhe në humbjen graduale të qëllimit fillestar të aktivitetit të prokurimit.

Nga dokumentacioni i AK-së rezulton se:

- nuk ekziston planifikim buxhetor i miratuar për realizimin e projektit;
- nuk është nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë përkatëse;
- projekti nuk është i përfshirë në listën e projekteve kapitale për vitin aktual dhe vitet pasuese;
- projekti nuk i përmbush më karakteristikat teknike dhe dimensionet e kërkuara;
- segmenti rrugor është planifikuar të përfshihet në një projekt tjetër strategjik.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se vazhdimi i procedurës së prokurimit do të rezultonte në shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me planifikimin buxhetor, përgjegjësinë financiare dhe parimet themelore të prokurimit publik, shkelje të cilat nuk mund të rregullohen apo të parandalohen përmes amendamentit të kushteve të prokurimit.

Për rrjedhojë, në përputhje me nenin 62 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të përfundojë aktivitetin e prokurimit, pasi vazhdimi i tij do të çonte në zhvillimin e një procedure që nuk mund të realizohej në përputhje me ligjin.

Po ashtu, duke u mbështetur në nenin 1 të LPP-së, konstatohet se aktiviteti i prokurimit ka humbur qëllimin dhe funksionin e tij fillestar dhe nuk garanton më shfrytëzim efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike.

Në këtë kontekst, si pasojë e moszbatimit të vendimeve të OSHP-së dhe ndryshimit të rrethanave faktike, financiare dhe institucionale, aktiviteti i prokurimit nuk i shërben më realizimit të interesit publik në formën dhe kushtet në të cilat është inicuar.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se:

- vendimi i AK-së për përfundimin (anulimin) e aktivitetit të prokurimit është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik;
- ky vendim është i ligjshëm, i arsyetuar dhe proporcional;
- pretendimet ankimore të OE ankues lidhur me kundërshtimin e anulimit të aktivitetit janë të pabazuara.

Prandaj, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues për përfundimin e aktivitetit të prokurimit të mbetet në fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues, me çrast ka konstatuar se vendimi për anulimin e kësaj procedure duhet të mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por e pamjaftueshme për të ndryshuar rezultatin e kësaj vendimarrje të AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues KOMUNA E GJAKOVËS., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X”, me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: